



**KOMUNA E SHITES**  
**DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Nr.09/5

Datë: 27.1.2025

**THIRRJE PUBLIKE**

**PËR OFRIMIN E MBËSHETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE QË KONTRIBUOJNË  
NË ZHVILLIMIN DHE MASOVIZIMIN E SPORTIT NË KOMUNËN E SHITES**

Në bazë të nenit 12 të Rregullorës MF Nr.04.2017 mbi kriteret, standardet, dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve:

1. Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpallë thirrje për të gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masovizimin e Sportit.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte/programet e tyre për fushat prioritare në vijim:  
**2.1. Të gjitha OJQ-të-Klubet Sportive, në Komunën e Shtimes, programi i të cilave është i fokusuar në fushën e sportit.**
3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në avancimin dhe fuqizimin e Sportit.
4. Vlera totale e planifikuar, e thirrjes është: **70,000.00 euro**
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune, nga data **27.1.2025** deri më datë **14.2.2025, në ora 16:00.**
6. OJQ-të mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje, por vetëm me një projekt për fushën sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të thirrjes është deri në **dhjetor të vitit 2025.**

**KRITERET PËR APLIKIM**

1. Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, së paku tre muaj para datës së publikimit të thirrjes publike.
2. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e lartë përmendura.
3. OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryera transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofertuesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofertuesve tjerë të mbështetjes financiare publike.
4. Para nënshkrimit të kontratës OJQ duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

5. OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen.
6. OJQ-të duhet të dorëzojnë një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.
7. OJQ-të të cilat nuk kanë dorëzuar raportet financiar dhe narrativ nga financimi i vitit 2024, nuk mund të aplikojnë

**Disa nga dokumentet kryesore të cilat kërkohen të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:**

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative)
2. Certifikatën e numrit fiskal (Obligative)
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative).
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative)
5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (Obligative)
6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera (Obligative)
7. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme
8. Të dorëzojë deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;
9. Të dorëzojë CV të menaxherit të projektit

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në uebfaqën e internetit të Komunes së Shtimes.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën:

Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës / Komuna Shtime / Zyra e Sportelit .

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlersimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.